



KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT KASKO

1.TERMA TË PËRGJITHSHME

- 1.1."Kushtet e sigurimit" të kontratës "Kasko", këtu më poshtë do të quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit", që nënkuption kushtet e përgjithshme dhe te veçanta të kontratës për sigurimin Kasko të mjeteve motorike të pranuara dhe nënshkruara nga palët.
- 1.2. "Siguruesi" këtu më poshtë do të quhet shoqëria e sigurimeve "ANSIG" SH.A.
- 1.3. "I Siguruari" personi, i cili kryen sigurimin "Kasko" sipas kësaj kontrate sigurimi.
- 1.4."Përfituesi" nënkuption personin fizik ose juridik të përcaktuar në Policën e Sigurimit si përfitues i dëmshpérblimit me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, i cili ka interes pasuror.
- 1.5. "Përdorues" nënkuption personat që përdorin mjetin motorik të siguruar, emrat e të cilëve janë të shënuar detyrimisht në kontratën e sigurimit dhe për të cilët është i vlefshëm mbulimi në rast sigurimi.
- 1.5. "Mjet motorik" nenkupton një mjet motorik vetlëvizës, tokësor, i projektuar për përdorim në rrugët publike.
- 1.6. "Mjet Motorik i Sigruar" kupton mjetin motorik ose rimorkion për të cilën është paguar primi i sigurimit dhe është zgjedhur periudha dhe mbulimi përkatës.

2.OBJEKTI I SIGURIMIT

- 2.1.Objekti i sigurimit sipas këtyre kushteve janë humbjet apo dëmtimet e plota ose të pjesshme të tyre, si rezultat i rreziqeve të parashikuara në këto kushte sigurimi, në përputhje me, përcaktimet e bëra në policën e sigurimit kundrejt pagimit të primit të sigurimit sipas rreziqeve të siguruara nga i siguruari.
- 2.2. Siguruesi nuk mbulon në sigurim dhe nuk përgjigjet për fitimin e munguar.

3. RREZIQET E SIGURIMIT

Siguruesi, do të dëmshpérblejë të Siguruarin deri në shumën e siguruar të përcaktuar në policë dhe/ose pyetësorin e marrjen në sigurim të nënshkruar i siguruari, për humbjet, dëmtimet e plota ose të pjesshme në mjetin motorik të siguruar, të shkaktuara nga rreziqet:

1. Dëmtimet aksidentale
2. Thyerja e xhamave
3. Katastrofat natyrore
4. Zjarri, rrufeja, eksplozioni
5. Dëmtimi në parkim
6. Vjedhja
7. Dëmtimi nga aktet keqdashëse

3.1. DËMTIMI AKSIDENTAL i mjeteve për shkak të përplasjes apo përbysjes,

Siguruesi do të paguajë dëmet përgjatë kohëzgjatjes së policës, të cilat i shkaktohen mjetit motorik nga:

- a. Përplasja me një objekt fiks ose të lëvizshëm
- b. Përbysja e mjetit ose dalje nga rruga

Nuk mbulohen:

- a. dëmet në mjetin motorik të siguruar, si rezultat i konsumit normal, defekteve apo avarive të brendshme elektrike apo mekanike te mjetit.
- b. Dëmet e shkaktuar në mjetin motorik të siguruar nga persona të paindentifikuar dhe shkaqe të paindentifikuara nga i siguruari dhe/ose organet shtetërore përkatëse.

3.2. THYERJA E XHAMAVE, mbulohet zëvendësimi i xhamave të përparëm, të pasëm, anësorë, te tavaneve të lëvizshëm si dhe xhamave të fenerëve të shkaktuar nga goditja e një objekti të lëvizshëm duke përfshirë plasaritjen deri tek thërmimi i tyre.

Nuk mbulohen:

- a. Dëmet në mbulesat ose perdet mbrojtëse nga dielli.
- b. Dëmet në xamat të cilët nuk janë të përfshirë në "Katallogun e prodhimit" por janë të vendosur nga "I sigurari".

3.3. KATASTROFA NATYRORE

- a. Janë të mbuluara dëmet që shkaktohen nga **Stuhia, Breshëri, Dëbora, Tufani, Përmbytja, Vërvshimi**.
- b. Katastrofat natyrore do të mbulohen në sigurim vetëm nëse është deklaruar si e tillë nga autoritetet shtetërore.
- c. Mbulohen sipas kësaj kontrate edhe dëmet e ardhura si rezultat i përmbytjes së garazhdit, nëse kjo vjen si pasojë e një katastrofe natyrore
- d. Siguruesi do të paguajë gjithashu dhe dëmet e shkaktuara në mjetin motorik të siguruar nga rënia e objekteve te ndryshme, që ndodhin si pasojë e katastrofave natyrore.

"*Përmbytje*" do të konsiderohet dalja e ujit nga kufijtë normalë të rrjedhjeve naturale apo artificiale, të liqeneve, rezervuarëve duke kaluar bregun, ledhet, cektinat, digat dhe shpërndahet për shkak të rrymës së ujit me nivel të lartë si dhe vërvshimi i ujit në rrugë për shkak të rreshjeve shumë të mëdha e të papritura.

"*Vërvshimi*" do të konsiderohet dalja e ujit të një lumi a përrroi jashtë shtratit të tij, i cili derdhet me vrull e përmbyt vendin përreth.

"*Stuhii*" do të konsiderohet një çrregullim atmosferik me një lëvizje ajri me shpejtësi jo më të vogël se 17.2 m/s ose 62 km/orë, të klasifikuar dhe nga organet kompetente të meteorologjisë, e cila mund të shoqërohet me shira, dëborë ose rreshje të tjera.

"*Breshëri*" do të konsiderohen reshjet që formohen nga pikat e shiut të ngrira si akull në ajër në madhësi të tillë e të klasifikuar nga organet kompetente të meteorologjisë.

"*Dëbora*" do të konsiderohet rreshja atmosferike e ngurtë që bie flokë-flokë nga retë në trajtë kristalesh të bardhë me formë dhe përmasa të ndryshme.

"*Tufani*" do të konsiderohet era e vrullshme zakonisht me shi të madh, breshëri a dëborë të dendur.

Nuk mbulohen:

- a. Dëmet të cilat shkaktohen nga tërmeti dhe rrëshqitja e tokës;
- b. Dëmet nga kalimi i lumenjve ose përrrenjve me mjetin motorik.

3.4. ZJARRI, EKSPLOZIONI DHE RRUFEJA

Janë të mbuluara dëmet nga Zjarri dhe Eksplozioni të cilët shkaktohen nga faktorë të jashtëm dhe përshtjnë mjetin e siguruar dhe Rrufeja, e cila bie direkt mbi mjetin motorik.

Nuk mbulohen:

- a. Dëmet që shkaktohen nga shkaqe të brëndshme të mjetit motorik.
- b. Dëmet që shkaktohen nga pirja e duhanit në mjetin motorik.
- c. Dëmet, nëse nuk janë deklaruar në Rajonin e policisë apo në Repartin e zjarrëfikësit.
- d. Demet e shkaktuara nga zjarri ose eksplozioni ne mjetin motorik nga persona te paindentifikuar.

3.5. DËMTIMI NE PARKIM

"Dëmtimi në Parkim nga një mjet motorik" mbulon në sigurim dëmet, që vijnë si rezultat i dëmtimit të mjetit motorik, vetëm në rastet kur ai ndodhet i parkuar në një vend të caktuar dhe nuk mund të identifikohet shkaktari i aksidentit.

Në këtë rast dëmtimi i mjetit kur është i parkuar në parkim do të mbulohet deri në një vlerë dëmi prej 50,000 Lekë.

Nuk mbulohen:

- a.Dëmet e shkaktuara mjetit motorrik të parkuar si rezultat i neglizhencës për parkim të gabuar të siguruar apo të autorizuarve prej tij;
- b.Dëmet e shkaktuara në mjetin motorik si rezultat i gabimeve apo neglizhencës të përfaqësuesve të parkimit privat, lavazhove ose serviseve;
- c. I siguruari detyrohet të bëjë foto të vendit të ngjarjes dhe mjetit të dëmtuar dhe ti depozitojë ato pranë siguruesit, në të kundërt ky i fundit gjëzon të drejtën të çlirohet nga dëmshpërblimi.

3.6. VJEDHJA

Vjedhje: do të konsiderohet çdo veprim i përvetësimit në mënyrë të fshehtë, i kundraligjshëm nga një ose disa persona kundrejt mjetit motorik të siguruar. Janë të mbuluara dëmet, që shkaktohen nga vjedhja e plotë ose e pjesëshme e mjetit si dhe dëmet në tentative vjedhje, të vërtetuar nga organet kompetente shtetërore.

Tentativa për vjedhje do të konsiderohet çdo veprim që ka synuar vjedhjen e mjetit motorik të siguruar por që nuk ka arritur të kryhet, duke shkaktuar dëme ndaj mjetit motorik. Këtu mbulohen vetëm dëmet e shkaktuara mjetit motorik si pasojë e tentativës për vjedhje të vërtetuar nga organet kompetente shtetërore.

Nuk mbulohen:

- a. Dëmet nga vjedhja të kryera nga I Siguruari/Përdoruesit e mjetit motorik, punonjësit e shërbimit, punonjësit të cilët ruajnë apo mbikqyrin vendin e punës apo të parkimit.
- b. Dëmet nga vjedhja të shkaktuara nga mos mbyllja e dyerve, tavanëve të lëvizshme, xhamave ose në rastin kur çelësat e makinës janë lënë brenda mjetit, mbi ose përreth tij.
- c. Dëmet nga vjedhja e cila ka ndodhur nga shkaqe të pashpjegueshme pa shenja e gjurmë të dukshme
- d. Dëmet nga vjedhja e mjetit me dhunë duke përdorur armë ose imitacione të tyre nga persona të paidentifikuar që vënë në kërcënim jetën e të Siguruarit.

Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit I Siguruari është i detyruar t'i dorëzojë Siguruesit të gjithë kopjet e çelësave.

I Siguruari duhet të deklarojë çdo humbje të çelësit të makinës tek Siguruesi, në rast të kundërt Siguruesi nuk mban përgjegjësi për rastin e sigurimit.

Në rastin e vjedhjes së pjesëshme, Siguruesi do të dëmshpérblejë të siguruarin duke e vërtetuar nga organet shtetërore për vjedhjen e aksesorëve ose elementeve të perfshirë në katalogun e prodhimit.

Këtu mbulohen vetëm dëmet e shkaktuara mjetit motorik si pasojë e vjedhjes së pjesëshme, të vërtetuar nga organet kompetente shtetërore.

- b. Në rastet kur ato janë kryer nga vetë i siguruari apo persona të tjerë të udhëzuar apo urdhëruar prej tij ose përdorues të tjerë.
- c.Siguruesi që ka paguar shpérblimin e dëmit ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës të paguar nga personat që janë përgjegjës për shkaktimin e dëmit.
- e. Dëmtimet e sistemeve dhe pajisjeve që nuk janë të nevojshëm për nisjen dhe drejtimin e mjetit, por që janë vendosur në të. Këto mbulohen vetëm kur janë pjesë funksionale e ndërtimit në bazë të mjetit motorik me përdorim special.

3.8. AKTET KEQDASHËSE

Janë të mbuluara dëmet që shkaktohen nga veprimet keqdashëse mbi mjetin motorik të siguruar, gjatë qëndrimit ose qarkullimit të tij.

"Akte keqdashëse" do të kuptojmë dëmet e ndodhura në mjetin motorik nga veprime të kryera me vullnet të plotë në mënyrë të qëllimshme apo keqdashëse nga palë të treta pa miratimin, dijeninë dhe/ose pëlqimin e të siguruarit të shoqëruar me fotografi të mjetit të dëmtuar në vendin e ngjarjes dhe raportin e policisë. Mbulohen në sigurim dëmet e shkaktuara mjetit motorrik të siguruar nga akte që synojnë shkatërrimin e mjetit motorik me zjarr apo eksploziv të qëllimshëm apo me mjete te tjera.

Nuk mbulohen:

- a.dëmet e shkaktuara mjetit motorrik të siguruar nga vetë i siguruari apo persona të tjerë të udhëzuar apo urdhëruar prej tij.
- b.dëmet nga lufta, revolucioni, puci ushtarak, aktet terroriste, grevat, konfiskimi apo shkatërrimi i mjetit motorrik.

4.PËRJASHTIME TË PËRGJITHËSHME

Nuk do të mbulohen dëmet e shkaktuara në mjetin motorik si rezultat i:

- 4.1. Shpërthimit bërthamor, rezatimit bërthamor, ndotjes radioaktive, rezatimeve ionizuese, ndotjeve kimike;
- 4.2. Luftës së çdo lloji, invazioni, luftime të tjera të armatosura, pavarësish nëse është dekluaruar lufta ose jo, lufta civile; turbullira civile, revolucioneve, lëvizjeve separatiste, kryengritje popullore ose ushtarake, rebelime, revolta, puçe, grushte shteti, eksode; akteve terroriste, trazirave, grevave, sabotimeve, akteve të armiqve të jashtëm, gjendjes së shtetrrethimit ose të jashtëzakonshme.
- 4.3. Dëmet në mjetin e siguruar, të bllokuar ose në tentativë bllokimi nga Organet e Shtetit.
- 4.4. Dëmet e shkaktuara qëllimi dëmet që udhëzuara nga personi i Siguruar.
- 4.5. Dëmet që shkaktohen nga Përdorues, emrat e cilëve nuk janë shënuar në Policën e sigurimit, perjashtuar familjarët e të siguruarit bazuar në të dhënat e çertifikates familjare, si dhe e përdoruesve të autorizuar.
- 4.6. Dëmet që rezultojnë nga defekte të prodhimit, konsumi normal, defektet apo avaritë e brendshme elektrike apo mekanike gjatë ndezjes ose lëvizjes së mjetit.
- 4.7. Dëmet nga prerjet apo skopjimi i gomave, por jo dëmet që pasojnë.
- 4.8. Dëmet e shkaktuara nga Përdoruesit, të pa pajisur me "Dëshminë e Aftësisë" për drejtimin e mjetit edhe kur këta janë të shënuar në policën e sigurimit apo familjare të të siguruarit.
- 4.9. Dëmet e shkatuara nga drejtuesi i mjetit kur ky ndodhet nën ndikimin e efekteve të alkoolit, drogës ose refuzon t'i nënshtrohet provave të këtij kontrolli.
- 4.10. Dëmtimi i mjetit në të paktën 70% të vlerës së tij, në rastin kur kjo humbje nuk shoqërohet me lëndime trupore të drejtuesit të mjetit apo të pasagjerëve.
- 4.11. Dëmet e shkaktuara në mjet nga transportimi i lëndëve radioaktive, eksplozive, gërryese, ndezëse, jonizuese etj. Siguruesi do ti paguajë këto dëme nëse është rënë dakord më parë duke paguar një prim shtesë.
- 4.12. Dëmet në mjetin motorik të shkaktuara gjatë kryerjes së operacioneve të shërbimit, riparimit, kontrollit, larjes, parkimit, dorëzimit ose shitjes.
- 4.13. Dëmet ose humbjet e objekteve, sendeve personale, mallrave ose bagazheve që ndodhen në momentin e rastit të sigurimit.
- 4.14. Nuk mbulohet zmadhimi i humbjeve ose dëmeve për shkak të neglizhencës të të Siguruarit ose mosmarrjes së masave parandaluese, për parandalimin e tyre.
- 4.15. Dëmet që zmadhohen artificialisht nga i siguari për kalimin e vlerës së franchizës, me qëllim përfitimin e mbulimit me sigurim.
- 4.16. Dëmet e shkaktuara nga materialet apo kafshët që transportoheshin me këtë mjet.
- 4.17. Dëmet e shkaktuara nga rimorkiot që i janë lidhur mjetit (aktive apo pasive).
- 4.18. Dëmet që shkaktohen nga manovrat kur mjeti shtyhet me forcën e krahut.
- 4.19. Dëmet që shkaktohen kur mjeti kalon në shtigje rrugësh apo qarkullon në rrugë të pashtuara, të painventarizuara (hapësira jo për qarkullim mjetesh).

- 4.20. Dëmet që janë shkaktuar me qëllim dhe/ose të udhëzuara nga i siguruari, nga kontraktuesi, nga personat që bashkëjetojnë me të siguruarin, nga të punësuarit e tij, nga personat që transporton, nga ata që janë të ngarkuar për të drejtuar, riparuar apo ruajtur mjetin.
- 4.21. Dëmet e shkaktuara pjesëve të mjetit të cilat jane vendosur vetë nga i siguruari dhe nuk janë pjesë e katalogut të prodhimit;
- 4.22. Dëmet që pëson mjeti motorik si rezultat i pjesëmarrjes në gara përfshirë ato sportive të autorizuara apo të paautorizuara.
- 4.23. Pronësia, funksionimi, mirëmbajtja ose përdorimi i çdo automjeti, përdorimi kryesor i të cilit është:
- a) Transporti i eksplozivëve të lartë, të tillë si nitro-glicerina, dinamiti ose ndonjë eksploziv tjetër i ngashëm;
 - b) Transporti me shumicë i gazit të lëngshëm të naftës ose benzinës ose ndonjë lëngu të ndezshëm;
 - c) Transporti i kimikateve ose gazzave në formë të lëngët, të kompresuar ose të gaztë.
- 4.24. Siguruesi, nuk do të jetë përgjegjës për humbje të mjeteve, të cilat rezultojnë të vjedhura me parë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 4.25. Në çdo kërkësë, padi ose procedurë tjetër gjyqësore, ku Siguruesi, deklaron se, sipas parashikimeve të mësipërme, humbja apo dëmtimi nuk mbulohen në sigurim, barra për të provuar që kjo humbje, shkatërrim, dëmtim apo përgjegjësi mbulohet, do t'i takojë të Siguruarit.

5. SHTIRJA TERRITORIALE

- 5.1. Kontrata është e vlefshme vetëm për dëmet që ndodhin në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 5.2. Zgjerimi i territorit mund të bëhet me marrëveshje midis palëve, kundrejt pagesës së një primi shtesë. Mbulimi në sigurim jashtë territorit të Republikës të Shqipërisë përfshin shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe shtete të tjera siç janë : Maqedoni, Kosovë, Mali i Zi, Kroaci, Rusi, Turqi dhe Serbi.

6. SHUMA E SIGURIMIT

- 6.1. Shuma e sigurimit është vlera për të cilën është siguruar mjeti motorik. Shuma e sigurimit vendoset në policën e sigurimit me marrëveshje midis Siguruesit dhe të Siguruarit.
- 6.2. Shuma e siguruar, mund të jetë e barabartë me vlerën e blerjes së mjetit motorik të ri, kur ky merret në sigurim në momentin e vënyies në qarkullim për herë të parë, sipas katalogut ose me vlerën e tregut.
- 6.3. Në rast se, të dy palët bien dakord, që shuma e siguruar të jetë më e vogël se vlera e tregut të mjetit motorik, do të kemi nënsigurim dhe do të zbatohen procedurat e seksionit "Nënsigurimi".

7. POLICA E SIGURIMIT

- 7.1. Siguruesi, i dorëzon të siguruarit, një dokument të firmosur nga ana e tij, Policën e sigurimit, e cila vërteton pranimin e Kushteve të Përgjithshme nga i Siguruar si dhe lidhjen e Kontratës së Sigurimit.
- 7.2. Polica e sigurimit, lëshohet në bazë të kërkësës me shkrim të të Siguruarit/autorizuarit të tij "Pyetësori", i cili është formular standard i përgatitur nga Siguruesi.
- 7.3. I Siguruarit, është përgjegjës, lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të bëra prej tij.
- 7.4. Siguruesi, ka të drejtë të verifikojë vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të të Siguruarit dhe të kryejë inspektimë për saktësimë të dhënat.
- 7.5. Pas plotësimit të kërkësës për sigurim, i Siguruarit nuk mund të kryejë ose lejojë ndryshime që sjellin shtimin e rrezikut, pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Me shtim të rrezikut kuptohen rrethanat që janë thelbësore, të cilat mund të influencojnë në vendimin e Siguruesit për të lidhur ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendosë. Në rast të moszbatimit të kushtit të mësipërm, Siguruesi çlironhet nga detyrimi për dhënen e dëmshpërbimit.
- 7.6. Siguruesi, lëshon policën e sigurimit e cila vërteton pranimin e Kushteve të Përgjithshme nga i Siguruar si dhe përcakton primin e sigurimit, në bazë të njoftimeve dhe deklarimeve të bëra nga i Siguruarit në "Pyetësor". Kërkësat dhe deklarimet e tjera të të Siguruarit, i bashkëngjiten dhe janë pjesë e Policës së Sigurimit. Polica e sigurimit nënshkruhet nga të dy palët, Siguruesi dhe i Siguruar ose personat

e autorizuar prej tyre dhe lëshohet pas pagesës së primit të sigurimit, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe.

7.7. Kur, Polica e Sigurimit, humbet ose dëmtohet, në masën që bëhet e pavlefshme, me kërkesën dhe shpenzimet e të Siguruarit, Siguruesi ,duhet të lëshojë një dublikatë të saj.

7.8. Të drejtat dhe detyrimet e të Siguruarit në këtë kontratë nuk mund të kalojnë tek një person tjetër pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Ky miratim do të shoqërohet me ndryshimet përkatëse në kontratën e sigurimit. Çdo parashikim apo pretendimin i ndryshëm me parashikimin e paragrafit të parë të kësaj pike është i pavlefshëm dhe e çliron siguruesin nga detyrimi për mbulim në sigurim.

7.9. Kërkesa për Sigurim

Kupton kërkesën e të Siguruarit për sigurimin e mjetit të tij duke i dhënë përgjigje formularit standart të përgatitur nga Siguruesi. I Siguruari ose personi i autorizuar nga ai, nënshkruan së bashku me agjentin ose inspektorin e marrjes në sigurim kërkesën për sigurim dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e deklarimeve të bëra në të. Pas plotësimit të kërkesës për sigurim, i Siguruari nuk mund të kryeje ose lejojë ndryshime që sjellin shtimin e rrezikut, pa miratimin me shkrim te Siguruesit. Me shtim të rrezikut kuptohen rrethanat që janë thelbësore të cilat mund të influencojnë në vendimin e Siguruesit për të lidhur ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendose. Ne rast të mosbatimit të kushtit të mësipërm, Siguruesi clirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit.

7.10. Natyra dhe Shtrirja

Kontrata e sigurimit përcakton të drejtat dhe detyrimet e paleve, natyrën dhe shtrirjen e mbulimeve si dhe ndryshimet e primeve që rezultojnë nga ndryshimi i faktoreve të rrezikut. Ajo nënshkruhet nga të dy palët, Siguruesi dhe i Siguruari ose personat e autorizuar prej tyre dhe lëshohet pas pagesës së primit të sigurimit, përvèc rasteve kur është përcaktuar ndryshe.

8. PRIMI I SIGURIMIT

8.1. I Siguruari, paguan primin ose këstин e sigurimit detyrimisht përpëra datës dhe orës kur është parashikuar të hyjë në fuqi polica e sigurimit.

8.2. Tarifa e primit të sigurimit përcaktohet në bazë të llogaritjeve, sipas mbulimit të zgjedhur, klasifikimit dhe veçorive të mjetit motorik dhe vendoset në policën e sigurimit.

8.3. Pagesa, do të quhet e kryer, në momentin e kalimit të shumës së caktuar për llogari të Siguruesit.

8.4. Në rast mospagimi të primit të sigurimit brenda datës dhe orës kur është parashikuar të hyjë në fuqi polica e sigurimit, polica e sigurimit pezullohet automatikisht dhe nuk krijon efekte juridike për Siguruesin deri në orën 24:00 të ditës që paguhet primi i sigurimit.

8.5. Polica e sigurimit në rast se nuk është paguar primi i sigurimit do të qëndrojë e pezulluar për një periudhë kohore prej 29 ditësh kalendarike dhe pas kalimit të këtij afati ajo zgjidhet automatikisht pa pasur nevojë për njoftim. I Siguruari në këtë rast është i detyruar të paguajë Siguruesin për kostot/shpenzimet administrative.

9. APLIKIMI I SISTEMIT TARIFIMIT BONUS - MALUS

9.1. Në rinovimet e kontratave për mjetet që kane përfituar dëmshpërblim nga sigurimi kasko, do të rezervojë të drejtën të aplikojë MALUS që nënkuption rritje të primit të sigurimit e cila do të jetë në masën 20% të primit të llogaritur.

9.2. Në rinovimet e kontratave për mjetet që nuk janë përfshirë në aksidente, pra nuk kanë përfituar dëmshpërblim sipas kontratës kasko, për 2 vite të njëpasnjëshme, do të rezervoje të drejtën të aplikojë BONUS, që nënkupton ulje, e cila do të jetë në masën 10% të primit të sigurimit.

10. PERIUDHA E SIGURIMIT

10.1. Periudha e sigurimit, është një vjecare, e cila përcaktohet në policën e sigurimit.

10.2. Mbulimi me sigurim, fillon në orën 24.00 të ditës së përcaktuar si ditë e fillimit me kusht që të jetë paguar primi i sigurimit dhe përfundon në orën 24.00 të ditës së përcaktuar si ditë mbarimi të mbulimit në sigurim në Policën e Sigurimit. Në çdo rast mbulimi në sigurim do të fillojë dhe do të krijojë efekte juridike për siguruesin vetëm pasi të jetë paguar primi i sigurimit.

10.3. Në rastet kur pagesa e primit të sigurimit është kryer më parë, përgjegjësia e Siguruesit, fillon në momentin kohor të përcaktuar në policë, pavarësisht momentit të kryerjes së pagesës.

11. PJESA ZBRITSHME

11.1. Në rastet e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit do të zbatohet pjesë e zbritshme. Siguruesi do të zgresë nga dëmshpërbimi i llogaritur, pjesën e zbritshme të përcaktuar në policën e sigurimit.

11.2. Masa e pjesës së zbritshme përcaktohet për çdo rast dëmi, dhe është 20% e dëmit për rrezikun e vjedhjes dhe 10% e dëmit për rreziqet e tjera. Në rast se i siguruari preferon riparimin e mjetit jashtë serviseve të autorizuara të shoqërisë, pjesa e zbritshme zbatohet në masën 20%. Në këto raste siguruesi mund të zbatojë dhe franshizë, nëse gjykohet e nevojshme, gjatë procesit të marrjes në sigurim.

11.3. Për dëmin e dytë pjesa e zbritshme do te jetë 30% për rrezikun e vjedhjes, dhe 20% për të tjera.

12. PËRFUNDIMI DHE ZGJIDHJA POLICËS SË SIGURIMIT

Polica e sigurimit përfundon në rastet e mëposhtme:

- a. kur mbaron afati i treguar në policën e sigurimit;
- b. në mënyrë të njëanshme kur njëra nga palët nuk përmblush detyrimet kontraktore.
- c. kur përgjegjësia bie mbi Siguruesin, I Siguruari ka të drejtë mbi pjesën e primit të paguar për periudhën e mbetur të sigurimit;
- d. kur njëra nga palët heq dorë nga polica e sigurimit;
- e. pas një ngjarje, e cila konsumon tërë shumën e mbetur të sigurimit;
- f. pasi janë konsumuar dy ngjarje sigurimi.

Polica e sigurimit zgjidhet në rastet e mëposhtme:

- a. Nuk është paguar primi i sigurimit ose kësti vijues i primit të sigurimit, ose primi i sigurimit për kontratat e rinovuara, sipas afateve të përcaktuara në seksionin 8.
- b. Ka të dhëna për pasaktësi të informacionit të dhënë nga I Siguruari. I Siguruari mund ta zgjidhë kontratën duke njoftuar 30 ditë përpëra datën e zgjidhjes.
- c. Kur të siguruarit ose përdoruesit të mjetit motorik iu është hequr dëshmja e aftësise gjatë muajve të fundit.
- d. Kur pas lidhjes të kontratës të sigurimit pushon interesit pasuror i të siguruarit, transferohet pronësia, kontrata e sigurimit quhet e zgjidhur. Me shqyrtimin e kërkesës për dëmshpërbim, të paraqitur nga i Siguruari, Siguruesi, ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit, duke i kthyer të Siguruarit, pjesën e primit të mbetur.

13. DETYRIME

13.1. Siguruari, duhet të informojë me shkrim Siguruesin, për të gjitha rrëthanat e njohura prej tij dhe që janë thelbësore për vlerësimin e rrezikut. Rrëthanat, konsiderohen thelbësore, nëse i Siguruari është pyetur me shkrim nga Siguruesi, ose ato janë të një natyre të tillë, që mund të influencojnë në vendimin e Siguruesit, për të lidhur ose refuzuar kontratën, apo për kushtet që do të vendosë.

13.2. Siguruesi, ka të drejtë të zgjidhë Policën e Sigurimit brenda 45 ditëve nga fillimi i saj, për shkak të pasaktësisë së informacionit të dhënë nga i Siguruari. Në këtë rast, i Siguruari, nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e primit të sigurimit.

13.3. I Siguruari, pas lidhjes së Kontratës së Sigurimit, duhet të njoftojë me shkrim çdo ndryshim në mjetin motorik, që sjell si pasojë rritjen e rrezikut.

13.4. Siguruesi, ka të drejtë, nga çasti i shtimit të rrezikut, të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit, afatin e sigurimit, ose të zgjidhë kontratën.

13.5. Mosnjoftimi nga i Siguruari, sjell si pasojë çlirimini e Siguruesit nga detyrimi për pagesën e dëmshpërbimit.

13.6. I Siguruari, duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshëm, për të mbrojtur nga dëmtimet apo humbjet mjetin motorik, duke e mbajtur në kushte të sigurta dhe eficente.

14. DYSIGURIMI

14.1. Nëse, i Siguruari, kryen një tjetër sigurim (dysigurim) për mbulimin e rreziqeve në përputhje me këto Kushte të Përgjithshme, ai duhet t'i komunikojë Siguruesit të parë, emrin e siguruesit tjetër si edhe shumën e siguruar.

14.2. Në rast se, qëllimisht apo për shkak të negligencës, i Siguruari, nuk plotëson detyrimet sipas paragrafit të mësipërm, Siguruesi, ka të drejtë të zgjidhë Policën e Sigurimit dhe të mos kthejë primin.

14.3. Në rastin e dysigurimit, masa e dëmshpërblimit nga të dy kontratat, nuk mund të jetë më e madhe se vlera e humbjes, duke zbritur pjesën e zbritshme.

14.4. Nëse, i Siguruari, kryen sigurime të tjera me qëllim që, të arrijë përfitime të paligjshme, kontrata e sigurimit, quhet e pavlefshme dhe Siguruesi mban primin e sigurimit.

15. NËNSIGURIM

15.1. Siguruesi dhe i Siguruari, mund të bien dakord për sigurimin e mjetit motorik për një shumë sigurimi më të vogël se vlera e tregut apo e blerjes së mjetit motorik të ri. Në këtë rast mjeti motorik quhet i nënsiguruar dhe dëmshpërbllimi që do të përfitojë i Siguruari, do të llogaritet duke shumëzuar, vlerën e dëmit me koeficientin e nënsigurimit. Koeficienti i nënsigurimit, është raporti i shumës së siguruar kundrejt vlerës së tregut apo të blerjes së mjetit motorik të ri.

15.2. Nënsigurimi, do të zbatohet, edhe nëse në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, shuma e siguarar, është më e ulët se vlera e tregut apo e blerjes së mjetit motorik të ri.

16. MBISIGURIMI

16. NËSE SHUMA E SIGURUAR ëSHTË PËRCAKTUAR MË E LARTË SE VLERA E TREGUT APO VLERA E BLERJES SË TË NJËJTË MJET MOTORIK TË RI, SIGURESI DHE I SIGURUARI, KANË TË DREJTË TË BËJNË NDRYSHIMET PËRKATËSE NË POLICËN E SIGURIMIT, DUKE ZYOGËLUA SI SHUMËN E SIGURUAR ASHTU DHE PRIMIN E SIGURIMIT.

16.2. Në çdo rast, kufiri i përgjegjësisë së Siguruesit, nuk do të jetë më i lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit tip mjeti motorik të ri, duke zbritur piesën e zbritshme.

16.3. Nëse, i Siguruari, lidh kontratën e sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. Siguruesi, ka të drejtën e mbaitjes së primit të sigurimit.

17. RIVENDOSJA E SHUMËS TË SIGURUAR

17.1. Mbës pagesës së çdo dëmi shuma e siguruar do të rivendoset në vlerën e saj fillestare në rast se i siguruarit paguan primin shtesë.

siguruar paguar primit shtesë.
17.2. Pas pagesës së dëmshpërblimit, mjeti motorik, qëndron i siguruar deri në fund të afatit të caktuar në kontratë, për një shumë të barabartë me diferencën midis shumës së sigurimit dhe dëmshpërblimit të paguar. I Sigruarit, mund të rivendosë, shumën e siguruar, kundrejt pagesës së primit shtesë të llogaritur nga Siguruesi.

17.3. Në rast se i siguruari nuk paguan primin shtesë pra nuk e rivendos shumën e siguruar, atëherë mjeti motorik qëndron i siguruar deri në fund të afatit të caktuar në policën e sigurimit kasko për një "shumë të re sigurimi" e barabartë kjo me diferençën e shumës të sigurimit fillestare dhe vlerës së dsmshpërblimit, pra për një dëm të dytë, i siguruari do të dëmshpërblehet sipas shumës të re të sigurimit, pra me nënsigurim.

18. NJOFTIMI I RASTIT TË SIGURIMIT DHE VLERËSIMI I DËMIT

Në rastin e ndodhjes së një ngjarje sigurimi, I Siguruari ose përfaqësuesi ligjor i tij duhet të njoftojë menjëherë rastin e sigurimit sipas afateve të mëposhtme:

menjëherë rastin e sigurimit sipas arateve të mposhtimit.

18.1. Të njoftojë Siguruesin dhe Përfituesin, duke specifikuar rrethanat e ngjarjes. Një njoftim i tillë, do të jetojë nëpër tillë Siguruesit, përsë ashtë dhënë brenda 24 orëve nga ndodhja e ngjarjes.

konsiderohet i dhene Siguruesit, nese eshte dhene brenda 24 orëve nga momenti i 18.2. Brenda 24 orëve nga momenti i ndodhjes së ngjarjes se sigurimit, i Siguruari, detyrohet menjëherë të njoftojë sipas rastit të sigurimit, Policinë Rrugore, të Rendit, Zjarrfikësit dhe të verë në dispozicion të Siguruesit, vërtetimin e autoriteteve të lartpërmendura, lidhur me njoftimin e bërë, të shoqëruara me foto të vendit ngjarjes dhe mjetit të dëmtuar e ti depozitojë ato siguruesit, në të kundërt, siguruesi gjëzon të drejtën të cilirohet nga dëmshpérblimi. Siguruesi ka të drejtë të dëmshpérblejë për dëmet deri në masën

300,000 Lekë, pa nevojën e raportit të policisë, por objekt aprovimi rast pas rasti nga strukturat përgjegjëse në shoqëri.

18.3. Siguruesit i vihet në dispozicion një kopje e denoncimit pranë organeve kompetente, apo raportit të policisë dhe "Njoftimi i Rastit të Sigurimit", jo më vonë se 24 orë nga momenti ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

18.4. "Vërtetim Miqësor i Ngjarjes, Njoftimi i Rastit të Sigurimit", i përgatitur më parë nga Siguruesi duhet të plotësohet me ndershmëri dhe në afatet e mësipërme, pa shtrembërimë të fakteve të rastit të sigurimit nga I Siguruari, të shoqëruar me të gjitha të dhënat identifikuuese përkatëse të mjetit motorik, të dëmtuar apo humbur, foto të vendit të ngjarjes dhe mjetit të dëmtuar si dhe rrëthanat përkatëse të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

18.5. Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, I Siguruari duhet të paraqesë kërkesën për dëmshpérblim brenda afateve të përcaktuara nga Kodi Civil, vetëm pasi ka bërë njoftimin e rastit sipas formularit standart. Në rast të kundërt, Siguruesi ka të drejtë të çlirohet nga detyrimet për pagesën e dëmit.

18.6. Siguruesi, gjëzon të drejtën të çlirohet nga detyrimet e tij për dëmshpérblim nëse:

a.I Siguruari, me qëllim apo për neglizhencë, nuk zbaton tërësisht apo pjesërisht detyrimet e tij;

b.I Siguruari , përpinqet të paraqesë në mënyrë të shtrembër ose mashtruese, faktet para Siguruesit, fakte të cilat kanë rëndësi përmundësinë dhe /ose masën e dëmshpérblimit.

18.7. Siguruesi, ka të drejtë, të verifikojë rrëthanat në të cilat ka ndodhur Rasti i Sigurimit, si dhe të kryejë ekspertizën e dëmit apo të humbjeve në mjetin motorik të siguruar, brenda 15 ditësh nga dita e njoftimit të ngjarjes së sigurimit. Gjatë kësaj periudhe, i Siguruari, është i detyruar të mbajë mjetin motorik të dëmtuar në dispozicion të Siguruesit, pa e riparuar atë.

18.8. Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, do të zbatohet pjesa e zbritshme dhe (ose) franshiza. Masa e pjesës së zbritshme dhe dhe franshizës, vendoset në policën e sigurimit. Për çdo rast dëmi, Siguruesi do të zbresë nga shpérblimi i llogaritur, pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit në përqindje dhe/ose shumë absolute. Siguruesi nuk do paguajë dëme të veçanta, që janë nën shumën e përcaktuar si franshizë në kontratën e sigurimit.

19. DËMSHPËRBLIMI DHE PAGESA E DËMIT

19.1. Siguruesi do të paguajë të Siguruarin, Përfituesin ose trashëgimtarin ligor të tij për dëmet në mjetin motorik të siguruar, deri në limitin maksimal të përgjegjësisë, duke zbritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit. Në rastin e aplikimit të franshizës, dëmet me vlerë më të vogël se franshiza, nuk paguhen.

19.2. Siguruesi në varësi të dëmit, përcakton formën e dëmshpérblimit si më poshtë:

a. Riparim i mjetit të dëmtuar, në pikën e riparimit të ofruar nga Siguruesi.

b. Pagesë e vlerës së dëmit.

c. Zevendësim i mjetit të dëmtuar, me një mjet tjetër analog.

19.3. Masa e dëmshpérblimit duhet të jetë deri në vlerën e dëmit të ndodhur dhe në asnjë rast dëmshpérblimi nuk mund të tejkalojë limitin maksimal të përgjegjësisë të percaktuar në policën e sigurimit, pasi është hequr dhe pjesa e zbritshme e përcaktuar në policën e sigurimit.

19.4. Siguruesi, mund të shtyjë kohën e pagesës:

a. Për aq kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e të Siguruarit, për të marrë pagesën.

b. Në qoftë se, janë filluar hetime penale, në lidhje me ngjarjen e sigurimit kundër të Siguruarit.

c. Për aq kohë sa, i Siguruari, nuk paraqet dhe plotëson dokumentat e kërkua nga Siguruesi.

d. Kur vlera e dëmit, është më e lartë se 80% e shumës se siguruar, mjeti motorik do të konsiderohet dëm total.

19.5. Siguruesi ka detyrimin të paguajë dëmin brenda afatit prej 30 ditësh, pas pranimit të njoftimit të "Rastit të Sigurimit" dhe pas dorëzimit të dokumentave të nevojshme nga ana e të Siguruarit.

19.6. Në qoftë se mjeti është vjedhur, Siguruesi, pas 90 ditëve duhet të parapaguaje një pjesë të dëmshpérblimit, deri në 50% të shumës së sigurimit, nga dita e marrjes se njoftimit lidhur me ngjarjen e sigurimit dhe pjesen e mbetur të dëmshpérblimit me përfundimin e procedurave investiguese dhe procedurave penale.

- 19.7. I Siguruari do të njoftojë menjehërë nga ndodhja e vjedhjes, nëse mjeti i vjedhur gjendet.
- 19.8. Në rast se nuk është dhënë parapagimi, mjeti motorik i gjetur do të vihet në dispozicion të tē Siguruarit, ndërsa Siguruesi paguan dëmet që mund të këtë pësuar mjeti dhe që janë të mbuluara në sigurim.
- 19.9. Në rast se është bërë parapagimi nga Siguruesi deri ne limitin e përgjegjesisë dhe mjeti gjendet, ai do të vihet në dispozicion të Siguruesit, ndërsa të Siguruarit do t'i paguhet pjesa e papaguar deri në shumën e sigurimit.
- 19.10. I Siguruari ka të drejtë të marrë mjetin duke kthyer parapagimin e bërë nga Siguruesi duke reduktuar nga kjo pagesat për dëmet që mund të ketë pësuar mjeti.
- 19.11. Pjesa e papaguar deri në shumen e sigurimit duke zbritur pjesën e zbritshme, duhet paguar kur të gjitha proçedurat investiguese janë myllur, por jo më shumë se 2 vjet.
- 19.12. Në rast se është kryer pagesa e dëmit deri në shumën e sigurimit dhe mjeti gjendet, ai do të vihet në dispozicion të Siguruesit. I Siguruari ka të drejtë të marrë mjetin duke kthyer pagesën që i është bërë.
- 19.13. Në rast se I Siguruari nuk është dakord me dëmshpërblimin e ofruar, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit nga Siguruesi, duhet të paraqesë refuzimin me shkrim.
- 19.14. Në rast se I Siguruari ka bërë deklaratë të rreme, është implikuar në veprime mashtrimi duke përvetësuar me të padrejtë një dëmshpërblim, Siguruesi ka të gjitha të drejtat e personit të dëmtuar kundërtij.
- 19.15. Siguruesi do të rimbursojë për shpenzimet e transportit e të ngarkim-shkarkimit nga vendi i ndodhjes së rastit të sigurimit (për mjetin që nuk vetëlëviz) deri në vendmbërritje.
- 19.16. Në rast mosmarrëveshje, por vetëm pasi Siguruesi ka ofruar vlerësimin e tij, të dy palët krijojnë një komision arbitrazhi të paanshëm me pjesëmarrjen e ekspertëve të se cilës palë dhe të një eksperti të tretë. Shpenzimet e këtij komisioni përcaktohen në momentin e krijimit të tij dhe përballohet nga palët.

20. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 20.1. Mosmarëveshjet midis të Siguruarit dhe Siguruesit do të zgjidhen me mirëkuptim.
- 20.2. Në rastet kur ato nuk zgjidhen me mirëkuptim, ato do të zgjidhen në Gjykatën e Vendit ku është lidhur kontrata e Sigurimit.
- 20.3. Për gjithçka që nuk është parashikuar në këto kushte, do të aplikohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil.
- 20.4. Pjesë përbërëse dhe të pandara të kontratës së sigurimit kasko, janë: Polica e sigurimit, kushtet e përgjithshme, formulari dhe pyetësori i marrjes në sigurim dhe çdo dokument tjeter që i bashkëlidhet.

I siguruari deklaron se ka lexuar, kuptuar qëllimin dhe ka rënë dakord me termat dhe kushtet e kësaj kontrate sigurimi, si dhe i pranon ato me forcën e ligjit dhe nënshkruan pa rezerva kontratën e sigurimit.

ANSIG SH.A

SHOQËRI SIGURIMI